



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 18.07.2018

Dokument parlamentar

RAPORT

PËR PROJEKTLIGJIN "PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES FINANCIARE, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCave DHE EKONOMISË, DHE CASSA DEPOSITI E PRESTITI S.p.A., PËR PROGRAMIN E ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL NËPËRMJET INOVACIONIT"

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 18 korrik 2018, shqyrtoi projektligjin "Për ratifikimin e marrëveshjes financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe Cassa Depositi e Prestiti S.p.A., për programin e arsimit dhe formimit profesional nëpërmjet inovacionit", propozuar nga Këshilli i Ministrave në zbatim të neneve 81, pika 1 dhe 100 të Kushtetutës dhe nenit 17, të ligjit nr.43/2016 "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë".

Në mbledhjen e Komisionit ishin të pranishëm për t'iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve specialistë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Duke marrë në konsideratë marrëdhënien reciproke të miqësisë mes dy vendeve, si dhe në përputhje me Protokollin për Bashkëpunim dhe Zhvillim mes Qeverisë së Republikës së Italisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë 2014-2016, në të cilin arsimit dhe trajnimit profesional nëpërmjet inovacionit identifikohen si mjete thelbësore për zhvillimin e burimeve njerëzore, zhvillimin dhe kohezionin social e territorial të vendit tonë, u miratua në prill të vitit 2017 ligji nr. 51 që ratifikonte marrëveshjen e bashkëpunimit me qeverinë e Italisë për programin "Në mbështetje të arsimit dhe formimit (AFP) nëpërmjet inovacionit".

Në vijim të ligjit të sipërpërmendur Këshilli i Ministrave ka miratuar me vendimin nr. 376 datë 27.06.2018, projektligjin "Për ratifikimin e marrëveshjes financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe Cassa Depositi e Prestiti S.p.A., për programin e arsimit dhe formimit profesional nëpërmjet inovacionit".

Nëpërmjet këtij projektligji Cassa Depositi e Prestiti S.p.A (CDP) angazhohet ti akordojë një kredi të butë prej 5 milion eurosh vendit tonë për financimin e programit të arsimit dhe formimit profesional nëpërmjet inovacionit. Në bazë të kushteve dhe afateve të përcaktuara në këtë Marrëveshje Financiare, CDP-ja akordon kredinë e butë me termat që vijon:

- **Kohëzgjatja:** 22 vjet

- **Periudha pa pagesë principali:** 120 muaj, duke filluar nga data e disbursimit të parë në Llogarinë e Posaçme;
- **Shlyerja:** 24 kështe principali të njëpasnjëshme, të barabarta, çdo gjashtëmuajor,
- **Norma e interesit:** 0%

Kredia e Butë do të ndahet në katër komponentë:

- A) 1,263,000.00 Euro për financimin e rehabilitimit dhe ndërtimit të infrastrukturës;
- B) 2,240,000.00 Euro për financimin e laboratorëve dhe pajisjeve;
- C) 1,335,000.00 Euro për financimin e asistencës teknike institucionale;
- D) 162,000.00 Euro për financimin e asistencës për ministrinë përgjegjëse.

Rezultatet e pritshme nga miratimi i kësaj kredie:

- Favorizimi i hyrjes në botën e punës të studentëve të Institutit Bujqësor Rakip Kryeziu në Fier dhe Institutit Mekanikë Bujqësor në Lushnjë,
- Ngritja e një Qendre Multifunksionale Trajnimi në Institutin Bujqësor “Rakip Kryeziu” në Fier,
- Fuqizimi i Institutit Mekanikë Bujqësor në Lushnjë,
- Përpunimi dhe transmetimi i kurrikulave arsimore të studentëve në përputhje me standardet e BE-së,
- Krijimi i marrëdhënieve të qëndrueshme dhe efikase mes dy shkollave profesionale dhe tregut të punës në sektorin e bujqësisë dhe agro-ushqimor,
- Sigurimi i koerencës dhe sinergjisë me programimin IPA II në Shqipëri përsa i përket punësimit dhe formimit profesional.

Gjithashtu, në nenet e marrëveshjes janë vendosur klauzola që parashikojnë që kredia të mos përdoret për të financuar taksat vendore, detyrimet doganore e TVSH-në si dhe që në rast të mos përdorimit të fondeve të disbursuara brenda 24 muajve nga data e disbursimit, ato do të kthehen menjëherë CDP-së.

E rëndësishme të përmendet është edhe kontributi i shtetit Italian ndër vite për zhvillimin e qëndrueshëm social-ekonomik të Shqipërisë në procesin e integritetit në BE, si dhe angazhimi financiar i dhënë nga Cassa Depositi e Prestiti S.p.A. për disa projekte të rëndësishme si:

- Bashkëfinancimi i projektit të Bankës Botërore “Rrugët kombëtare”, pjesa rrugore Tapizë-Fushë Krujë dhe urave në lumenjtë Drin dhe Mat.
- Mbështetje financiare për blerjen e energjisë elektrike nga Italia për të trajtuar mungesën e energjisë në Shqipëri.
- Programi për forcimin e seksionit rrugor Shkodër - Hani Hotit.
- Financimi i mallrave dhe shërbimeve për ndërtimin e një njësie për prodhimin industrial të produkteve dietetike për fëmijët.
- Krijimi i një projekti të telekomunikacionit të integruar.
- Financimi për rinovimin e linjës hekurudhore Tiranë-Durrës, e të tjera.

Duke qenë se nëpërmjet programit të arsimit dhe formimit profesional nëpërmjet inovacionit, arrihet të realizohet vizioni i qeverisë i shprehur në Strategjinë Kombëtare për Punësim dhe Aftësim 2014 – 2020, që shërben në finale për të pasjen e një ekonomie konkurruese dhe një shoqëri gjithëpërfshirëse që bazohet në aftësi në nivel më të lartë dhe punë më të mira për gjithë gratë e burrat deri në 2020, Komisioni e miratoi projektligjin me votat e shumicës së anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

RELATORE

KRYETARI

Evis KUSHI

Erjon BRAÇE